

# 5 SUPERHERONJTË E KURSIMIT TË ENERGISË ELEKTRIKE






# Fëmijë të dashur,

Ju po rriteni çdo ditë, dhe siç e keni vërejtur, me ju rritet edhe roli juaj në shoqëri. Shpesh i thoni vetes se jemi të vegjël për të bërë ndryshime të mëdha, por mos harroni, se ndryshimet e mëdha në shoqëri vijnë si bashkëdyzim i shumë veprimeve të vogla.

Të gjithë i kujtojmë fjalët e urta që shpesh na i kanë thënë gjyshërit tanë, si: Gur-gur bëhet mur, apo Pika-pika mbushet lumi.

Ky është edhe mesazhi që duam ta përçojmë me këtë libër. Bota të cilën e shijojmë, do të mund të bëhet edhe më e mirë, nëse ne të gjithë e vëmë nga një gur në atë mur.

Me këtë libër, ne po ju japim vetëm disa ide se si mund të bëni ndryshime të vogla për një botë më të mirë, por shpirti juaj i madh do të lindë me qindra ide të tjera, që do t'ju sigurojnë një jetë të begatë në një planet të shëndoshë.



*Tung,*  
*unë jam Drita*


**Funksioni:** LED Drita  
**Vendlindja:** Prishtinë  
**Misioni:** Ta ndriçojë botën

**KARAKTERISTIKAT:**  
70-90% më efikente  
në kursimin e energjisë,  
Jetëgjatësi pesëmbëdhjetë  
herë më të madhe,  
Prodhon 70-90% më pak nxehtësi


*"Shndrit, dhe jeto gjatë në një botë të pastër."*



Si fëmijë, Drita e dinte se ishte ndryshe nga të tjerët. Ajo gjithmonë sfidonte poçet (llambat) tjera dhe prodhonte më pak nxehtësi. Kjo bënte që poçet tjera të ishin xheloze dhe ta ngacmonin atë, sepse vetëm ajo shndriste ndryshe dhe dallohej gjithmonë në shoqëri. Një ditë, një njeri i tha: "Vazhdo punën e mirë, LED!" "LED?", mendoi Drita, çfarë është ajo?




Ajo hulumtoi për veten dhe gjeti se LED ishte një diodë që emeton dritë. Drita po ashtu e kuptoi se shtëpitë që përdornin këtë diodë në vend të poçeve klasike, shpenzonin më pak para. Në vend se të paguanin 2.5 euro në muaj, paguanin vetëm 0.40 centë, ndërsa për një vit kursenin 25 euro. Mendoni tash, se sa poçe elektrike janë në shtëpinë tuaj dhe sa shumë para mund të kurseni me vetëm një ndryshim kaq të thjeshtë.



#### Këshilla e Dritës për ju:

Bindni prindërit tuaj që ta ndërrojnë poçin elektrik dhe të kursejnë energjinë!  
Është e thjeshtë, LED poçet si unë harxhojnë më pak energji elektrike dhe jetojnë më gjatë se poçet tjerë.




Hej,  
unë jam Bardha

**Funksioni:** Rrobalarëse  
**Vendlindja:** Prizren  
**Misioni:** T'i mbajë rrobat  
tuaja të pastra

**Karakteristikat:**  
Kursen para  
dhe energji elektrike

*"Nëse keni rroba të pastra,  
por një botë të ndotur,  
atëherë ju nuk keni asgjë."*

Bardha u rrit në një fshat të vogël në rrethinën e Prizrenit. Njerëzit në fshatin e saj punonin tërë ditën duke i larë rrobat me dorë. Bardha e vogël shihte njerëzit se sa të lodhur ishin duke i larë rrobat dhe se si uji i ndotur përzihej me ujin e përroit që e kishin afër shtëpive. Ata ndiqnin metodat e vjetra dhe e kishin të vështirë që t'i ndryshonin zakonet e punës së tyre. Bardha duke u rritur çdo ditë mësonte se si t'i bënte rrobat edhe më të pastra, duke prekur vetëm një pullë, por gjithashtu duke shpenzuar çdo herë edhe më pak energji elektrike. Bardha mori vendim që t'i bashkohet misionit të dritës LED dhe së bashku të bëheshin sa më efikënte. Ajo mund të mburret që ju sot jeni kaq të pastër.




Këshilla e Bardhës për ju:


Mbusheni rrobalarësen tuaj plot me rroba para se ta lëshoni në punë, sepse shpenzimi i energjisë elektrike është i njëjtë, qoftë kur ajo është e mbushur plot, qoftë kur është gjysmë e mbushur.

Po ashtu, nëse familja juaj ka vendosur që të blejë një rrobalarëse, ju duhet t'i këshilloni ata që gjithmonë të zgjedhin ato që shpenzojnë më pak.

Ju po ashtu duhet t'u tregoni prindërve tuaj që makina e larjes është më mirë të lëshohet për përdorim gjatë natës kur tarifa (çmimi) është më e ulët.



# *Përsëndetje nga unë, Beni*



**Funksioni:** Laptop


**Vendlindja:** Pejë

**Misioni:** T'i mësojë të tjerët, sidomos kompjuterët, që një pushim i vogël kursen shumë energji.

**KARAKTERISTIKAT:**


Punon shpejt,  
ka efikasitet të energjisë  
të përmirësuar, përdor 60%  
më pak energji elektrike

*"Unë jam i dobishëm edhe kur jam duke pushuar."*




Beni vjen nga një familje mendjendritur që jeton në Pejë. Babai i tij, një PC kompjuter dhe nëna e tij, një Mac Laptop, gjithmonë e mësonin Benin që të jetë tolerant ndaj të tjerëve dhe eficient i energjisë elektrike. Ai e nguliti këtë thellë në mendjen e tij. Koha e preferuar e Benit është kur ai kursen energjinë. Mirë, në fakt, është koha e gjumit, mirëpo duke fjetur ai kursen energji. Gjithashtu, Beni funksionon edhe me bateri, pa qenë në rrymë fare. Një ditë, Beni ishte duke fjetur në park. Drita dhe Bardha duke e parë gjithë atë energji që po kursente, i kërkuan atij që të bëhej pjesë e tyre dhe kështu që nga ajo ditë edhe Beni u vu në kërkim të miqve të tjerë eficientë.

Këshilla e Benit për ju: Fikeni kompjuterin apo laptopin kur ju nuk jeni duke e përdorur atë!





# Unë jam Shpejtimi



**Funksioni:** Veturë  
**Vendlindja:** Prishtinë  
**Misioni:** T'ju dërgoj ku të  
dëshironi


**KARAKTERISTIKAT:**  
40% më efiçiente  
në kursimin e energjisë

*"Jeto sastin, jeto mirë, jeto komod,  
jeto pastër në një botë pa tym e gazra!"*

Shpejtimi u lind në Prishtinë. Që i vogël i pëlqente shpejtësia. Gjithnjë lëvizte shpejt sa andej sa kënde. Nuk ndalej asnjëherë. Qëllimi i tij, edhe kur u rrit, ishte t'i dërgonte njerëzit aty ku dëshironin, në mënyrë sa më komode, efikase dhe sa më shpejt. Ai sot është shumë më eficient. Por, këtë e arriti duke pasur kujdes çfarë ha. Ka bateritë, përderisa kur i shterojnë ato, atëherë fillon të përdorë herë benzinën, herë naftën, herë gazin. Ai preferon që të përdorë bateritë sa më tepër, sepse me to as nuk bën zhurmë as nuk ndot ajrin, dhe është shumë më i lirë. Por, edhe kur ndonjëherë harxhohet, preferon gazin natyror. Edhe ai është i pastër dhe më i lirë se nafta e benzina. Më së paku dëshiron të konsumojë naftë. Ajo krijon ndotje dhe i dëmton stomakun.

Këshillat e Shpejtimit:

Unë jam i shpejtë, por asnjëherë mos më nisni shpejt. Nismëni ngadalë dhe filloni gradualisht ta rrisni shpejtësinë, por gjithmonë duke respektuar rregullat e trafikut. Kur prisni gjatë në ndonjë vend, fikmëni krejtësisht. Kam nevojë të pushoj dhe të mos e ndoti ambientin.





*Unë jam  
Drini*


**Funksioni:** Frigorifer

**Vendlindja:** Hajvali

**Misioni:** Ta mbajë ushqimin  
tuaj të freskët

**KARAKTERISTIKAT:**

25% më eficient në  
kursimin e energjisë



*"Ushqimet e freskëta  
janë baza e shëndetit tuaj!"*

Drini u rrit gjithmonë i lumtur përkrah familjes së tij, që çdoherë kishin synim t'u ndihmonin familjeve që ta mbanin ushqimin sa më të freskët. E vetmja e metë e tij ishte që më përpara shpenzonte shumë energji, rrjedhimisht edhe shumë para. Sigurisht që një gjë e tillë e brengoste, andaj ai çdo ditë përpiqej që të gjente mënyra se si të kursente më shumë. Dhe kështu, një ditë Drinit i erdhi një ftesë që t'i bashkohej ekipit të efijencës, në mënyrë që shpenzimet e tij të jenë minimale.

Këshilla e Drinit për ju:

Do të ishte mirë që mos të më lini shumë të hapur, ngase unë jam i dedikuar për ftohje dhe në momentin e hapjes, një sasi e nxehtësisë nga jashtë do të futet brenda, dhe kështu mua më duhet kohë më e gjatë për të ftohur ushqimet tuaja. Ushqimin e nxehtë apo të ngrohtë mos e vendosni brenda meje, fillimisht lëreni të ftohet, sepse mua do të më duhet energji më e madhe për ta ftohur atë. Po ashtu, mos më vendosni afër shporetit në kuzhinën tuaj. Meqë ai shërben për ngrohje dhe unë për ftohje, nuk i kemi edhe aq raportet e mira. Nxehtësia që ai liron, më pengon mua që të jem sa më eficient dhe të shpenzoj sa më pak energji dhe para. Prandaj, nuk do të ndihesha edhe aq rehat po ta kisha afër vetes.



## Shtëpia Efiçiente

Kështu, Drita, Bardha, Shpejtimi, Beni dhe Drini krijuan një 5-she fantastike, dhe të gjithë të tjerët sa herë që i shohin i thërrasin 5 superheronjtë e kursimit të energjisë elektrike. Këta superheronj pa dyshim që e kanë një shtëpi ku ata jetojnë dhe punojnë pa përtesë, për të na dhënë neve një jetë sa më të mirë. Kjo shtëpi njihet me emrin SHTËPIA EFIÇIENTE. Të shohim se çfarë mesazhi ka shtëpia efiçiente për ne:

Përsëritet, fëmijë të dashur!

Unë jam shtëpia efiçiente dhe brenda meje fshihen këta superheronj të famshëm, që tanimë besoj se i keni njohur dhe jeni bërë miq shumë të mirë. Ajo se çfarë më bën mua të ndjem efiçiente, janë pikërisht këta 5 superheronj. Por, misioni i këtyre 5 superheronjeve do të ishte i pamundur nëse ju dhe familjet tuaja nuk do t'i merrni parasysh edhe këto dy këshilla nga unë. Unë, si shtëpia efiçiente, karakterizohem me një izolim shumë të fortë dhe me dritare kualitative, që nuk e lejojnë të ftohtin gjatë dimrit ose të nxehtin gjatë verës të depërtojnë brenda meje. Për këtë arsye, unë gjithmonë ndjem e ngrohtë kur është ftohtë jashtë, dhe e freskët kur jashtë bën vapë. Kështu i mbroj dhe i bëj të ndjehen më produktivë 5 superheronjtë që jetojnë aty.





Prandaj, këshillat e mia për shtëpitë tuaja,  
janë:

1. Përdorni izolimin më të mirë të mundshëm. Nëse muret ndjejnë të ftohtë dhe i ftohti futet brenda tyre, atëherë prindërit tuaj do të shpenzonin dyfish më shumë para për t'i ngrohur përsëri, dhe humbet efekti i ngrohjes eficiente.
2. Po ashtu, kini parasysh që t'u vendosni dritare kualitative, njësoj si të miat. Edhe ato kanë nevojë të mbrohen nga acari ose nga vapa e madhe. Por, unë shpeshherë ndihem e vetmuar, sepse kam shumë pak shoqe. Do të doja shumë që t'i kisha shoqe të gjitha shtëpitë tuaja, do të doja shumë që edhe ato të ishin njësoj si unë, do të doja shumë të kisha shoqe gjithandej botës. Ta sundojmë botën dhe ta bëjmë atë një vend sa më të mirë, që ju të bëni jetë të qetë, të shëndetshme dhe më kualitative.





[keds-energy.com](http://keds-energy.com)  
[kesco-energy.com](http://kesco-energy.com)